



# FEDERATA E VOLEJBOLLIT TË KOSOVËS VOLLEYBALL FEDERATION OF KOSOVA

E-Mail: fvkosova@hotmail.com

TEL/FAX: +381 (0) 38 226 825

- Duke u bazuar në Rregulloren nr .2001/9 të dt .15 majit 2001 Mbi Kornizën Kushtetues për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë .
- Në bazë të Ligjit Mbi Sportin Nr . 2003/24,të dt 20 Nëntor 2003, veçanërisht nenet 6.7,17,20,27,28,29,30,31,32,33,dhe nenet 81,82 dhe duke u nisur nga të drejtat dhe detyrat e të gjitha institucioneve të edukimit fizik të sportit në Kosovë.
- Konformë Udhëzimit Administrativ Nr .02/2005 për Regjistrimin dhe licencimin e Federatave dhe Shoqërive sportive dhe në bazë të vullnetit të lirë të delegatëve të Kuvendit të FVK-së, Kuvendi i Federatës së Volejbollit të Kosovës në seancën e vetë të mbajtur më \_\_\_\_\_ aprovoi këtë :

## **S T A T U T** **TË FEDERATËS SË VOLEJBOLLIT TË KOSOVËS**

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

#### **Neni 1 .**

*Më këtë Statut rregullohen çështjet statutare dhe organizative të Federatës së Volejbollit të Kosovës, kushtet dhe mënyrat e zhvillimit të veprimtarive sportive,të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e bartësve të aktiviteteve, qëllimet e saja, selia , emblema, vula, mënyra e nxjerrjes së akteve normative, planeve dhe programeve, mjeteve financiare dhe çështjeve tjera për mirëvajtje dhe përparimin e Volejbollit në Kosovë.*

#### **Neni 2 .**

*Federata e Volejbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm FVK ) është asociacion i pavarur dhe i lirë sportiv i klubeve, i lidhjeve volejbollistike Komunale dhe ndër komunale e cila i bashkon të gjithë individët, shoqatat apo organizatat sportive, shoqatat qytetare, unionin e sporteve universitare si dhe i Shoqatës së trajnerëve dhe referëve me qëllim të organizimit sa më të suksesshëm të sportit të volejbollit dhe përparimin e tij , pa marrë parasysh gjininë ,ngjyrën, përkatësinë kombëtare e fetare , mendimin politik etj.*

*FVK është organizatë joqeveritare, jopolitike dhe joprofitabile.*

### *Neni 3 .*

*FVK-ja organizon dhe zhvillon përhapjen e lojës së volejbollit me aktivitetet e veta në degë të caktuara në tërë territorin e Kosovës ,dhe jashtë Kosovës më programe të posaçme të aprovuara nga Kuvendi dhe Bordi i FVK-së.*

### *Neni 4 .*

*FVK-ja bashkëpunon më Ministrinë e Sporteve të Kosovës,me Departamentet Komunale për sport të Kosovës,me Komitetin Olimpik të Kosovës si dhe me Ente dhe institucione të tjera të cilat dëshirojnë bashkëpunim.*

### *Neni 5 .*

*FVK-ja është person juridik . FVK - ja, inicion, organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e lojës së volejbollit në Kosovë, dhe atë mbi bazën e akteve të veta normative, të aprovuara konformë Ligjit për Sportin në Kosovë, Akteve Nën – Ligjore të sportit në Kosovë dhe akteve normative Ndërkombëtare. Federata, ka të vetmin qëllim organizimin,zhvillimin dhe përhapjen e lojës së volejbollit në degë të caktuara në gjithë territorin e Kosovës.*

*FVK-ja regjistrohet dhe licencohet në përputhje me Ligjin mbi Sportin e Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ për regjistrimin dhe licencimin e federatave dhe shoqërive sportive. Nr. 02/ 2005, Neni 12,13,14,15 dhe 16.*

*Garat Kampionale në rangje të ndryshme të lojës së volejbollit në Kosovë i organizon vetëm Federata e Volejbollit të Kosovës e cila është e licencuar në Ministri.*

*Mandati i licencës së lëshuar nga Ministria zgjatë 1 vit.*

### *Neni 6 .*

*FVK-ja e ka logon, vulën dhe flamurin e vetë .*

*Logoja është e paraqitur figurativisht me topin në rrjetën e volejbollit me tekst në gjuhën shqipe FEDERATA E VOLEJBOLLIT TË KOSOVËS dhe në gjuhën angleze VOLLEYBALL FEDERATION OF KOSOVA. Logoja është e realizuar në katër ngjyra. Logoja e FVK-së është e mbrojtur dhe mundë të përdoret vetëm me lejen e Bordit të FVK-së.*

*FVK-ja e ka vulën e vetë në formë të rrumbullakët me diametër 3,00 cm e cila përbën këtë tekst: Federata e Volejbollit e Kosovës, Volleyball Federation of Kosova , në mes është rrjeta e volejbollit me top dhe me tekst të shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze.*

*Flamuri dhe simbolet tjera të FVK-së kanë ngjyrë të kuqe, në mes rrjeti i volejbollit me top më mbishkrim: Federata e Volejbollit e Kosovës, në gjuhën shqipe dhe Volleyball Federation of Kosova në gjuhën angleze.*

*Selia e Federatës së Volejbollit të Kosovës është në Prishtinë, Rr“Agim Ramadani “ Nr – 48.*

## II. QËLLIMET, TË DREJTAT DHE DETYRAT PROGRAMORE

### *Neni 7.*

*Qëllimet të drejtat dhe detyrat e FVK-së janë për:*

- a) zhvillimin dhe përhapjen e parimeve të olimpizmit në degën e sportit të volejbollit.*
- b) masivizimin dhe përparimin e sportit të volejbollit ,*
- c) afirmimin e gjerë të punës shoqërore në sportin e volejbollit dhe në tërësi në lëmin e kulturës fizike,*
- d) kryerjen e punëve me interes publik e kombëtar ,për edukimin fizik të sportit,në veçanti të lojës së volejbollit,*
- e) zhvillimin e garave në pajtim me interesat dhe mundësitë,*
- f) shkollimin dhe përsosjen e kuadrove profesionale,*
- g) organizimin dhe udhëheqjen e garave kampionale në Kosovë,*
- h) kultivimi i marrëdhënieve të shëndosha njerëzore, zhvillimin social të vlerave të volejbollit përmes tolerancës,miqësisë,bashkëpunimit dhe parimeve të tjera të Kartës Olimpike ,Kartës Evropiane të Sportit në asociacione që e përbëjnë FVK-në.,*
- i) ngritja e cilësisë së sportit të volejbollit në shkallë ma të lartë kombëtare që synon ndërkombëtarizimin dhe afirmimin ndërkombëtar të volejbollit kosovar,*
- j) aktivizimin e klubeve te reja në qendrat të cilat nuk kanë qenë fare të aktivizuara gjerë më tani,*
- k) zhvillimin , bashkëpunimin dhe institucionalizimin e sportit(volejbollit) sipas përvojave evropiane dhe Federatave ndërkombëtare.*
- l) Lufton dopingun (mjetetet e palejueshme) në lojën e Volejbollit.*
- m) Zgjedh konfliktet (statutare dhe procedurale) brenda Federatës.*
- n) Kujdeset për sigurimin e mjeteve financiare për aktivitetet e veta dhe përcakton politikën financiare.*

### *Neni 8.*

*Federata e Volejbollit të Kosovës është e regjistruar dhe e licencuar në Departamentin e Sportit të Kosovës në kuadër të Ministrisë për Kulturë,Rini, Sport e Çështje jo-rezidente të Kosovës.*

*FVK-ja është anëtare e Asociacionit Olimpik të Kosovës (në vazhdim AOK) dhe synon të anëtarësohet në FIVB dhe CEV. FVK mund të anëtarësohet edhe në organizata sportive të niveleve të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës.*

### **III. THEMELET E ORGANIZATËS SË VOLEJBOLLIT**

#### ***Neni 9 .***

*Organizata bazë e sportit në të cilën, volejbollisti – lojtari, punëtori sportiv apo anëtar i tjetër e realizon aktivitetin e vetë volejbollistik, është Klubi i volejbollit*

*Klubi i volejbollit (privat apo publik) është anëtarë i Federatës e mund të jetë anëtarë i Shoqatës së klubeve të volejbollit të rangut ku bënë gara.*

*Shoqatat e klubeve nga alineja paraprake e këtij neni, mundë të formohen konformë Ligjit dhe aktave Nën – Ligjore të sportit të Kosovës dhe akteve tjera normative të FVK –së dhe në bazë të vullnetit të lirë të anëtarëve të saj.*

*Shoqatat i mbrojnë interesat e anëtarëve të vetë. Organizimi, të drejtat detyra dhe përgjegjësitë e këtyre Shoqatave, më afër përcaktohen me aktet normative të tyre.*

*Edhe volejbollistët – lojtarë, mundë të organizohen në shoqatat e tyre, e cila mund të jetë unike apo për secilin rang garash veç e veç.*

*Aktet normative të të gjitha shoqatave nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me këtë Statut apo me aktet tjera normative të FVK – së.*

#### ***Neni 10 .***

*Klubet volejbollistike janë të obliguara të nxjerrin të gjitha aktet normative të bazuara në Statutin e FVK-së . Funksionojnë në përputhje me Ligjin e Sportit, Aktet Nën – Ligjore, Statutin dhe rregulloret e Federatës përkatëse ndërkombëtare dhe akteve tjera normative të FVK-së, dhe për çdo vit janë të obliguara t'i dorëzojnë raportet mbi aktivitetin njëvjeçar, plan-programin e punës, planin financiar dhe raportin financiar në FVK apo pranë Departamenteve përkatëse.*

## IV. ANËTARËT E FEDERATËS

### **Neni 11 .**

*Anëtarët e Federatës janë të gjitha subjektet të cilat e kanë formuar FVK-në dhe organizatat sportive që i bashkëngjiten kësaj në përputhje me Statutin dhe aktet tjera normative si :*

- *Klubet e volejbollit,*
- *Shoqatat - : të gjyqtarëve, trajnerëve, klubeve, volejbollistëve etj.*
- *Lidhjet (shoqatat) rajonale të cilat mund të formohen me vullnetin e lirë të të interesuarve për anëtarësim në atë lidhje (shoqatë).*

*Federata, sipas marrëveshje, mundet që pjesë të detyrave, punëve dhe autorizimeve të veta t' iu bart Lidhjeve dhe Shoqatave nga pika 2 dhe 3 e këtij neni.*

### **Neni 12 .**

*Anëtarët e Federatës kanë të drejtë të formojnë shoqatat e tyre sportive, brenda juridiksionit të Federatës së Volejbollit të Kosovës, më qëllim që të unifikojnë aktivitetin e tyre.*

*Aktet normative të të gjitha shoqatave të krijuara nga anëtarët e Federatës, nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me këtë STATUT dhe aktet tjera normative të FVK-së.*

*Kushtet për anëtarësim në Federatë, rregullohen me akte të tjera normative të FVK – së.*

### **Neni 13 .**

*Për shkeljet serioze të STATUTIT, Rregulloreve dhe vendimeve tjera të Federatës, i jep të drejtë Kuvendit të Federatës të pezulloi çdo anëtarë të saj për një periudhë deri në 2 (dy) vite.*

*Në raste urgjente Bordi i Federatës mundë të bëjë pezullime të përkohshme deri në Kuvendin e radhës, i cili e ka obligim që të merr vendim lidhur me Vendimin e Bordit.*

*Çdo vendim për pezullim nënkupton humbjen e të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me statusin e anëtarit për aq kohë sa pezullimi mbetet në fuqi.*

### **Neni 14 .**

*Statusi i anëtarit të FVK – së përfundon në rast të dorëheqjes, përjashtimit ose shkrirjes së anëtarit.*

*Humbja e statusit të anëtarit, nuk e liron askënd nga detyrimet e veta financiare të pa përmbushura në raport me FVK –në , ose anëtarëve të tjerë.*

V. DETYRIMET E ANËTARËVE TË FEDERATËS

**Neni 15.**

*Anëtarët e Federatës së Volejbollit të Kosovës, kanë këto detyrime :*

- a) *Të jenë korrekt ndaj FVK – së, që nënkupton në veçanti se çdo anëtar në asnjë mënyrë të mos ndërmerr kurrfarë veprimesh që mund të jenë kundër interesave të FVK – së.*
- b) *Të paguajnë të gjitha detyrimet financiare ndaj FVK – së.*
- c) *Të njoftoj FVK – në, apo organet përkatëse për çdo ndryshim eventual në statutet dhe rregulloret e veta si dhe me listën e personave, ose zyrtarëve me të drejtë nënshkrimi për të hyr në marrëveshje ligjore me palë (persona) të tretë.*
- d) *Të përfillen në tërësi Statuti, Rregullorja e Brendshme dhe vendimet e FVK – së, FIVB-së, CEV – it dhe aktet tjera të dalura dhe të aprovuara nga Federata e Volejbollit të Kosovës.*
- e) *Të njoh dhe të zbatoi me përpikëri (ai dhe anëtarët) e tij ligjet dhe rregullat e lojës të vendosura nga Federata përkatëse Ndërkombëtare.*
- f) *Të parashikoi në çdo kontratë që ai lidhë me çdo lojtar ose zyrtar se në rast konflikti (kontesti) të mundshëm kompetent do të jenë organet e përcaktuara me aktet normative të FVK – së.*
- g) *Të mos mbaj asnjë lidhje të natyrës sportive me subjekte të panjohura nga FVK – ja.*
- h) *Të njoh të gjitha detyrimet që dalin nga ky Statut, nga Rregullorja e Brendshme dhe rregulloret tjera apo vendimet e FVK – së.*

VI. ORGANET E FEDERATËS SË VOLEJBOLLIT

**Neni 16.**

*Organet e FVK-së janë:*

- *K u v e n d i dhe*
- *B o r d i*

*K u v e n d i:*

**Neni 17.**

*Kuvendi i FVK-së është organi më i lartë i Federatës të cilin e përbëjnë Anëtarët e klubeve volejbollistike të Kosovës i cili ushtron detyrat e veta drejtpërdrejt dhe me ndihmën e organeve të veta ekzekutive dhe organeve tjera.*

*Në mbledhje të Kuvendit marrin pjesë me të drejtë vote delegat , të deleguar nga klubet volejbollistike të cilat marrin pjesë në garat e FVK-së, : Klubet e Super Ligës në Kuvend përfaqësohen me nga 1(një) ose 2(dy) delegatë.*

*Klubet e Ligës së parë dhe ligave të tjera përfaqësohen me vetëm nga një delegat.*

*Për klubet e femrave (vajzave) e obligueshme është që delegati të jetë femër. Nga numri i caktuar i delegatëve 10% duhet të jenë pakica – entitete , kurse Kuvendin e përbejnë 30% minimumi gjinia femërore.*

### ***Neni 18 .***

*Numri i saktë i delegatëve të Kuvendit të Federatës, caktohet para çdo seance të Kuvendit të Federatës, dhe ai mundë të jetë i ndryshueshëm varësisht nga numri i klubeve nëpër rangjet përkatëse të garave dhe nga numri i klubeve të licencuara në FVK.*

### ***Neni 19 .***

*Klubet apo asociacionet që kanë të drejtë të delegojnë delegatë në Kuvendin e Federatës së Volejbollit të Kosovës , në përputhje me Nenin 16 të këtij Statuti, e kanë për obligim që të njoftojnë Federatën për emrin e delegatit të tyre para çdo seance të Kuvendit të Federatës, dhe atë së paku 5 (pesë) ditë para datës së caktuar për mbajtjen e Kuvendit. Nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë, konsiderohet se delegatë i ati klubi apo asociacioni është ai që ka qenë në seancën paraprake të Kuvendit të FVK – së.*

### ***Neni 20 .***

*Mandati i delegatëve në kuvendin e FVK-së zgjatë 4 vite dhe ai mund të përsëritet vetëm edhe një herë.*

*Delegati duhet të jetë shtetas i Kosovës.*

*Kuvendi vendos në Seancë.*

*Kuvendi punon në mënyrë të plotfuqishme nëse në te marrin pjesë më tepër se 50% të delegatëve të zgjedhur.*

*Vendimi konsiderohet i aprovuar ( valid ) nëse për të kanë votuar më tepër se 50% të delegatëve të pranishëm.*

### ***Neni 21 .***

*Mbledhjet e Kuvendit mundë të jenë të rregullta ose të jashtëzakonshme.*

*Kuvendi i Rregullt mbahet njëherë në vit e sipas nevojës mund të mbahet më shpesh.*

*Kuvendin e thërret Kryetari i Bordit të FVK – së. Vendimin për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit, e bënë publik Kryetari i FVK – së, së paku 15 ditë para mbajtjes së seancës së Kuvendit.*

*Ftesa për rendin e ditës dhe materiali përkatës delegatëve (klubeve) dhe përfaqësuesve tjerë iu dërgohet së paku 5 ditë para mbajtjes së seancës së Kuvendit.*

### ***Neni 22 .***

*Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të FVK –së, mundë ta thërrasin :*

- *Kryetari i FVK-së me konsensus me anëtarët e Bordit të FVK – së, dhe*
- *2/3 e delegatëve të Kuvendit, nga numri i delegatëve në seancën paraprake të Kuvendit.*

*Propozuesi për mbajtjen e kuvendit të jashtëzakonshëm, duhet që Bordit të FVK-së, së bashku me propozimin për thirrjen e Kuvendit, ti propozoi edhe rendin e ditës dhe materialin përkatës.*

*Pas marrjes së propozimit valid për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, Kryetari i FVK – së e ka për obligim që më së paku 15 ditë nga dita e marrjes zyrtare të propozimit, të bëjë publike dhe të thërras mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit.*

*Kuvendi i jashtëzakonshëm mundë të debatoi dhe të vendos vetëm për çështjet për të cilën është thirrur.*

## ***Kompetencat e Kuvendit janë:***

### ***Neni 23 .***

- a) *Nxjerr dhe aprovon Statutin dhe aktet tjera normative të brendshme, bënë plotësimet dhe ndryshimet e tyre në bazë të Ligjit Mbi Sportin , dhe konformë Akteve Nën-Ligjore dhe Rregulloreve Ndërkombëtare dhe njëherit bënë interpretimin e tij.*
- b) *aprovon Rregulloren e punës së Kuvendit ,*
- c) *miraton dhe aprovon programin e punës dhe planin financiar,*
- d) *nxjerr Programin për Zhvillimin e Volejbollit për periudhën katër vjeçare,*
- e) *shqyrton raportin e punës dhe raportin financiar dhe të njëjtin e miraton ,*
- f) *përcakton bazat e bashkëpunimit ndërkombëtar ,*
- g) *miraton planin e zhvillimit të sportit të volejbollit ,*



- h) zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët tjerë të Bordit të FVK – së.*
- i) zgjedh dhe shkarkon Këshillin mbikëqyrës ,*
- j) debaton dhe e sugjeron Bordin për aprovimin e Rregullores së Brendshme të FVK-së*
- k) Vendos mbi faljen e dënimeve.*
- l) vendosë dhe kryen edhe për punët tjera të parapara me Statut.*

### *Neni 24 .*

*Votimet në Kuvendin e FVK-së bëhen me vota të fshehta , po qe se kuvendi nuk vendos ndryshe.*

*Procedimi dhe mënyra e punës së Kuvendit, më detajisht rregullohen me Rregulloren e punës së Kuvendit të FVK – së, të cilën e aprovojnë delegatët e Kuvendit të FVK – së.*

### *Neni 25 .*

*Shpenzimet e pjesëmarrjes në mbledhjen e Kuvendit të FVK – së i bartë vetë delegati i Kuvendit.*

*Kuvendi i FVK-së për punën e vetë i informon asociacionet që e përbëjnë atë.*

## *B o r d i*

### *Neni 26 .*

*Bordi është organ ekzekutiv i Kuvendit të FVK-së dhe ushtron punët në përputhje me këtë Statut.*

### *Neni 27 .*

*Bordi i FVK – së, numëron 11(njëmbëdhjetë ) anëtarë të cilët zgjedhën.*

*Kryetarin, nënkryetarin, sekretarin, arkëtarin, dhe pesë ( 5 ) anëtarë i zgjedh Kuvendi kurse 2 tjerë i emëron (koopton) kryetari i FVK-së.*

*Kryetari, nënkryetari, sekretari, arkëtari, nuk mundë të kenë funksione të dyfishta të jenë njëkohësisht të përfaqësuar apo të zgjedhur në poste të njëjta edhe në klubet e ndryshme volejbollistike.*

*Zgjedhja e Kryetarit dhe anëtarëve të Bordit bëhet me vota të fshehta, nëse vetë Kuvendi nuk vendos ndryshe.*

*Kryetari i Bordit njëkohësisht është edhe kryetar i Kuvendit të FVK – së.*

### ***Neni 28 .***

*Mandati i 5 (pesë) anëtarëve të Bordit të cilët i zgjedh Kuvendi dhe 2 (dy) të cilët i emëron(koopton) vetë kryetari, zgjat 4 (katër) vite me mundësi të rizgjedhjes edhe për 1 (një) mandat.*

*Në Bordin e Federatës duhet të jenë të përfaqësuara minoritetet dhe gjinia femërore ashtu siç është paraparë me dispozitat e Ligjit për Sportin e Kosovës dhe Akteve Nën-Ligjore.*

*Anëtarët e zgjedhur të Bordit janë delegatë të plotfuqishëm dhe me të drejtë vote në Kuvendin e FVK – së.*

### ***Neni 29 .***

*Mbledhjet e Bordit i thërret dhe i kryeson Kryetari i FVK - së. Në mungesë të tij, këtë mundë ta bëjnë nënkryetari ose sekretari i përgjithshëm.*

*Bordi për punë e vetë i përgjigjet Kuvendit të FVK – së.*

*Mënyra e punës së Bordit dhe marrjes së vendimeve, më detajisht përshkruhen dhe saktësohen në Rregulloren për punën e Bordit të FVK – së.*

***Bordi ka këto detyra, dhe kompetenca :***

### ***Neni 30 .***

- *të realizojë dhe zbatoi vendimet dhe konkluzat e Kuvendit të FVK-së,*
- *bënë zbatimin e normave të Statutit, të akteve të tjera të brendshme dhe të atyre ndërkombëtare, duke u bazuar në normat konkrete të së drejtës,*
- *të hartojë Rregulloren e vet të punës dhe Rregulloret e organeve tjera,*
- *përpilon plan-programe dhe planin financiar,*
- *harton projekte të nevojshme për FVK-në,*
- *nxjerr dhe aprovon sistemin dhe kalendarin e garave ,*
- *i propozon Kuvendit ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve tjera.*
- *emëron përzgjedhësit e reprezentacionit të FVK-së,*
- *vendosë për lëvdata , mirënjohje publike dhe shpërblime ,*
- *nxjerrë dhe aprovon Rregulloren e Brendshme,*
- *nxjerrë dhe aprovon Rregulloren Disiplinore,*
- *emëron gjyqtarin disiplinori,*
- *cakton lartësinë e anëtarësisë dhe kotizimeve për anëtarët e Federatës,*
- *cakton lartësinë e kompensimit për personat zyrtar të ndeshjeve,*
- *emëron dhe shkarkon të gjitha këshillat dhe komisionet e ndryshme që duhet të veprojnë në FVK.*
- *mbanë dhe zhvillon kontakte me institucionet ndërkombëtare dhe e përfaqëson Federatën.*

- *Kujdeset për punën e shoqatave të gjyqtarëve dhe trajnerëve si dhe për punën dhe aktivitetin e komisioneve të FVK – së.*
- *Përgatitë mbledhjet e Kuvendit dhe materialet përcjellëse për seancën e Kuvendit të FVK – së*

### ***Neni 31 .***

*Për punën e vet Bordi i përgjigjet Kuvendit të FVK-së.*

### ***Neni 32 .***

*Zgjedhja për anëtar të Bordit në Kuvend bëhet me vota të fshehta, çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të kandidohet për anëtar dhe poste të Bordit . Anëtarët e Bordit kanë të drejtë vote edhe nëse ndaj tyre kërkohet Votë-besimi .*

### ***Neni 33 .***

*Në Bord duhet të përfshihen 10% etnitetet dhe 30% gjinia femërore .*

### ***Neni 34 .***

*Në udhëheqësin e Bordit duhet të përfshihen : së paku një anëtar nga etnitetet dhe një e gjinisë femërore .*

### ***Neni 35 .***

*Bordi takohet ma së paku 1(një) herë në muaj dhe sipas nevojës edhe më shpesh. Vendimi konsiderohet i aprovuar nëse për te kanë votuar më tepër se 50% të anëtarëve të Bordit .*

*Bordi është shkalla e dytë dhe e fundit e shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave*

*Procedurat e ankesave janë të precizuara me aktet normative të FVK – së. Pala e pakënaqur me vendimet e komisioneve përkatëse, nëse mendon se ka pasur shkelje të akteve normative të FVK – së, ka të drejtë të i parashtroi Bordit të FVK – së, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.*

### ***Neni 36 .***

*Puna, detyrat përgjegjësit dhe obligimet e Bordit të FVK –së dhe anëtarëve të saj përcaktohen me Rregulloren e punës së Bordit të FVK - së .*

## VII. ORGANET E PËRHERSHME TË BORDIT

### Neni 37 .

*Organet e përhershme të Bordit janë:*

- *Këshilli për çështje urgjente,*
- *Këshilli profesional,*
- *Këshilli mbikëqyrës,*
- *Gjyqtari disiplinor,*
- *Shoqata e gjyqtarëve ,*
- *Shoqata e trajnerëve,*
- *Komisioni i garave,*
- *Komisioni për regjistrimin (federimin) e lojtarëve,*
- *Koordinatori për propagandë dhe marketing,*
- *Komisioni për mirënjohje,*
- *Komisioni për bashkëpunim Ndërkombëtar,*
- *Komisioni për Volejball të Plazhit (Beach Volley)*
- *Shoqata e klubeve,*

*Bordi mundë të emëroi dhe caktoi edhe komisione të tjera të përkohshme (ad-hoc) , të caktoi përbërjen e tyre, kompetencat obligimet dhe përgjegjësitë. Puna e të gjitha këtyre komisioneve rregullohet me Rregulloret e tyre të punës.*

*Në të gjitha këto organe vendimet merren me shumicë votash.*

### Neni 38 .

*Mandati i anëtarëve nga neni paraparak zgjat 4 (katër ) vite me të drejtë rизgjedhjeje edhe për një (1) mandat .*

## K r y e t a r i

### Neni 39 .

*Kryetari i FVK – së, njëkohësisht është edhe kryetar i Kuvendit dhe i Bordit të FVK-së.*

*Kryetari i Federatës zgjedhet në Kuvendin zgjedhor të Federatës.*

*Kandidatin për kryetar mundë ta propozojnë :*

- a) – *Bordi i Federatës ( ka të drejtë ta propozoi vetëm një kandidat) dhe*
- b) – *Kuvendi (me propozimin e më së paku 20 delegatëve të Kuvendit të Federatës)*

*Kryetarin e FVK-së e zgjedh Kuvendi me shumicë votash të anëtarëve prezent në seancën e Kuvendit*

*Kryetari i FVK-së zgjedhjet me vota të fshehta nëse anëtarët e Kuvendit nuk kërkojnë ndryshe .*

*Mandati i kryetarit zgjatë 4 (katër) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për 1 (një) mandat.*

### **Neni 40 .**

*Kryetari mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit, nëse e humb besimin në moskryerjen e detyrave të përcaktuara me Statut.*

*Shkarkimi i kryetarit bëhet në të njëjtën mënyrë si në procedurën e zgjedhjes së tij.*

*Në rast se Kryetari jep dorëheqje ose e humb besimin e delegatëve, Bordi cakton nënkryetarin si ushtrues detyre deri në kuvendin e jashtëzakonshëm.*

*Kryetari për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit të FVK-së së paku njëherë në vit.*

*Kryetari mundë të autorizoi edhe persona të tjerë që të përfaqësojnë Federatën para organeve të pushtetit, enteve,organizatave sportive etj .si brenda dhe jashtë vendit, si dhe në qarkullimin juridik me persona të tretë.*

### **A u t o r i z i m e t e k r y e t a r i t j a n ë :**

### **Neni 41 .**

- *Përfaqëson Federatën si i vetmi përfaqësues i saj ligjor.*
- *kujdeset për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit, Bordit dhe organeve tjera të saj.*
- *organizon , drejton dhe udhëheqë punën e Kuvendit dhe të Bordit ,*
- *thërret seancat e Kuvendit dhe të Bordit,*
- *kujdeset për ligjshmërinë e punës në Federatën e Volejbollit të Kosovës.*
- *është urdhërdhënës për zbatimin e planit financiar ,*
- *përfaqëson FVK-në para personave të tretë ,*
- *nënshkruan vendimet , konkluzat dhe procesverbalet e organeve të Kuvendit dhe të Bordit.*
- *ka të drejtë të largojë çdo anëtar të Bordit nëse nuk është aktiv dhe nuk vepron në frymën e akteve normative të FVK-së gjer në seancën e parë të Kuvendit.*
- *është përgjegjës për zbatimin e mjeteve materiale dhe raporton sipas nevojës, Bordit , Kuvendit të FVK-së dhe Ministrisë së sportit të Kosovës.*
- *ka të drejtë V e t o j e për çdo vendim të Bordit të FVK-së dhe organeve tjera , deri në mbledhjen e parë të Kuvendit .*
- *kryen edhe punë të tjera që kërkon momenti dhe të cilat janë në interes të FVK-së.*

## N ë n k r y e t a r i

### Neni 42 .

*Nënkryetarin e zgjedh Kuvendi i FVK-së me mandat 4 ( katër ) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një (1)mandat.*

### Neni 43 .

*Në rast të mungesës me të gjatë të kryetarit atë e zëvendëson nënkryetari, i cili ka autorizimet e plota të Kryetarit.*

## S e k r e t a r i

### Neni 44 .

- *është përgjegjës për zbatimin e të gjitha vendimeve të organeve të F V K-së*
- *është përgjegjës për zbatimin e plan-programit të FVK –së*
- *është urdhërdhënës i shërbimit profesional të FVK-së*
- *lidh marrëveshjet me palët e treta me pëlqimin e kryetarit dhe të Bordit të FVK - së .*
- *udhëheq me administratën e Federatës,*
- *merr pjesë në realizimin e bashkëpunimit me FITVB-në, CEV-in, dhe Federatat e volejbollit të shteteve të ndryshme,*
- *realizon bashkëpunimin me AOK-un, Departamentin e Sportit të Kosovës dhe organizmat tjerë sportiv në Kosovë,*
- *mban kontakte dhe i njofton mjetet e informimit me vendimet dhe konkluzat e organeve të FVK-së .*
- *përpilon plan-programet e punës së FVK-së*
- *kryen edhe punë të tjera sipas nevojës dhe në bazë të autorizimeve të kryetarit të Bordit të FVK – së.*

*Sekretarin e zgjedh Kuvendi i FVK-së me mandate 4 ( katër ) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për 1 (një)mandat.*

### Neni 45 .

*Në rast të mungesës së sekretarit, kryetari apo Bordi i FVK – së, mundë ta caktoj një personin që mundë ta zëvendëson atë.*

*Sekretari për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të FVK-së dhe kryetarit të Bordit të FVK-së .*

## A r k ë t a r i

### Neni 46 .

*Arkëtarin e zgjedh Kuvendi me mandate 4 ( katër ) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për 1 (një ) mandat .*

*Për punën e vet arkëtari i përgjigjet kryetarit , nënkryetarit , sekretarit , Bordit dhe Kuvendit të FVK – së.*

## D e t y r a t e A r k ë t a r i t j a n ë:

### Neni 47 .

- *mban dokumentacionin materialo-financiar të F V K-së,*
- *bën pranimin e të hyrave , bënë pagesat dhe evidentimin e daljeve materiale nga arka e FVK-së ,*
- *mban shënimet dhe evidencën që kërkon kontabiliteti,*
- *mban kontabilitetin për mjetet themelore dhe shpenzimet materiale të FVK-së.*
- *Përpilon dhe përgatitë bilancet periodike dhe përfundimtare ,*
- *është përgjegjës për dokumentacionin e FVK-së,*
- *zbaton vendimet, urdhëresat e Kryetarit , nënkryetarit , sekretarit dhe të Bordit të FVK -së.*

## K ë s h i l l i m b i k ë q y r ë s

### Neni 48 .

*Këshilli mbikëqyrës numëron tre (3) anëtarë, të cilët i zgjedh Kuvendi i FVK-së.*

*Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës nuk mundë të jenë anëtarë të Bordit të FVK –së.*

*Bordi i FVK-së dhe të gjitha organet tjera, janë të obliguara që Këshillit Mbikëqyrës t i mundësojnë kushte për punën e tyre që të veprojnë pa pengesa dhe të kenë qasje sipas kompetencave të parapara me Rregulloret përkatëse.*

*Këshilli mbikëqyrës nxjerrë Rregulloren e vet të punës.*

*Këshilli Mbikëqyrës e përcjellë ligjshmërinë e punës së Bordit dhe organeve tjera të FVK – së.*

*Këshilli Mbikëqyrës kujdeset për zbatimin e akteve dhe vendimeve të FVK-së.*

*Këshilli mbikëqyrës kujdeset për punën dhe veprimtarinë materialo-financiare të FVK-së.*

*Këshilli mbikëqyrës për punën e vet i raporton Kuvendit 1 (një) herë në vit për çështje financiare dhe çështje tjera .*

*Mandati i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është 4(katër vite) me të drejtë rizgjedhje edhe për 1(një) herë.*

## VIII. G A R A T

### **Neni 49 .**

*Garat zyrtare të volejbollit në Kosovë mundë të organizohen vetëm nga FVK-ja ose nga organi të cilën për këtë e autorizon Bordi i FVK – së.*

*Garat zhvillohen në bazë të rregullave të FIVB-së, Rregullores Teknike, dhe Rregullores së Brendshme të FVK-së.*

*Në udhëheqjen e garave, organi përkatës i garave duhet të respektoi të gjitha vendimet e FIVB – së, e CEV – it, që kanë të bëjnë me garat dhe rregullat e garave.*

*Sistemin e zhvillimit të garave si dhe propozicionet e garave i aprovon Bordi i FVK – së.*

## IX. EKIPET PËRFAQËSUESE TË KOSOVËS

### **Neni 50 .**

*Federata e volejbollit të Kosovës është e obliguar që të kujdeset për punën e ekipeve përfaqësuese të Kosovës dhe në përputhje me mundësit financiare duhet tu mundësoi kushte sa më të mira për punë.*

*Ekipeve përfaqësuese të Kosovës quhen skuadrat e zgjedhura nga FVK – ja, që janë të autorizuara që të përfaqësojnë Kosovën në të gjitha veprimtaritë ndërkombëtare.*

*Ekipeve që mundë ta përfaqësojnë Kosovën janë të parapara në Rregulloren e Brendshme të FVK – së, Neni 10.1*

*Paraqitja për ekipin përfaqësues të Kosovës është obligim dhe nder për çdo anëtarë të FVK – së.*

*Federata mundë të miratoi Rregullore të posaçme për punën e ekipeve përfaqësuese të Kosovës.*

*Ngjyrat tradicionale të fanellave të ekipeve përfaqësuese të Kosovës në volejboll janë Kuq – e Zi, ndërsa ngjyrat rezervë të fanellave është ajo e Bardhë.*

### **Neni 51 .**

*Caktimi i ekipeve përfaqësuese të Kosovës në Volejboll, sipas kategorive, mënyra e sigurimit të mjeteve për punë, kompetencat në udhëheqjen e punëve me ekipet përfaqësuese, stimulimi dhe shpërblimet për anëtarët e ekipeve përfaqësuese dhe përgjegjësia disiplinore e tyre, më detajisht rregullohen me Rregulloren e Brendshme për Ekipet përfaqësuese të Kosovës në volejboll.*



## X. SHËRBIMI ADMINISTRATIVO – PROFESIONAL NË FVK

### *Neni 52 .*

*Federata konformë kushteve dhe mundësive mundë të themeloi marrëdhënie pune me punëtor të cilët do të punojnë në shërbimin administrativo profesional të Federatës. Për punësimin eventual të punëtorëve dhe për lartësinë e të ardhurave personale, vendos Bordi i Federatës.*

## XI. RREGULLORET E BRENDSHME

### *Neni 53 .*

*Sistemi, Rregulloret e Brendshme të FVK – së dhe propozicionet e grave të miratuara nga Federata nuk mundë të ndërrohen apo të pësojnë ndryshime gjatë zhvillimit të edicionit të garave kampionale i cili është në rrjedhë e sipër.*

## XII. PASURIA DHE FINANCIMI I FEDERATËS

### *Neni 54 .*

*Pasurinë e Federatës e përbëjnë të drejtat pronësore në gjërat e luajtshme dhe të pa luajtshme : mjetet materiale (të hollat), letrat me vlerë dhe të drejtat tjetra pronësore të lejuara në bazë të ligjit.*

*Në rast të pushimit të punës së Federatës duhet të bëhet shpërndarja e pasurisë së Federatës konformë akteve normative që i përcakton Ligji dhe Rregullat e FVK – së.*

### *Neni 55 .*

*Në bazë të Ligjit mbi Sportin e Kosovës dhe Statutit të FVK-së, Federata e Volejbollit e Kosovës mjetet financiare i realizon nga:*

- a) Anëtarësia që paguajnë anëtarët e Federatës që është e rregulluar me aktet normative të FVK-së ,*
- b) Subvencionet nga Departamentet,*
- c) Donacionet që japin personat fizik dhe juridik,*
- d) Sponsorimet,*
- e) Pagesat që bëhen nga masat e shqiptuara disiplinore ndaj anëtarëve që shkelin Rregullat e lojës apo Rregulloren Disiplinore (dënimet me gjobë), dhe nga*
- f) Burimet nga aktivitetet tjera të lejuara në bazë të ligjit.*

*Me afarizmin financiar të Federatës udhëheq Kryetari i FVK – së, në bazë të planit financiar të aprovuar nga Kuvendi i Federatës dhe vendimeve të Kuvendit dhe Bordit të FVK – së.*

### ***Neni 56 .***

*Mjetet shfrytëzohen në përputhje me masat dhe kriteret të cilat i cakton Bordi i FVK - së me planin e vet financiar .*

## **XIII. PUNA PUBLIKE E FVK - së**

### ***Neni 57 .***

*Puna e FVK-së është publike dhe bëhet transparente përmes konferencave për media, informatorit, shtypit, buletinit etj . Anëtarët e vetë, Federata i njofton përmes : buletineve, procesverbaleve të mbledhjeve të organeve të veta , përmes shkresave ose përmes mjeteve të informimit publik.*

*Puna e organeve të Federatës, është publike dhe në përcjelljen e punimeve mundë të marrin pjesë përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.*

*Për seanca të mbyllura për opinion vendosin vetë organet e FVK – së.*

## **XIV. PUSHIMI I PUNËS SË FEDERATËS**

### ***Neni 58 .***

*Federata e Volejbollit të Kosovës mundë të pushoi së ekzistuari vetëm në rastet kur është paraparë me Ligjin mbi Sportin dhe aktet Nën-Ligjore të sportit të Kosovës dhe akteve normative të FVK – së,*

*Federata e sportit pushon të ekzistojë :*

- a) me vendimin Kuvendit dhe anëtarëve të saj,*
- b) në rast se numri i anëtarëve mbetet më i vogël se numri i anëtarëve të nevojshëm sipas kriterëve që i përcakton vetë FVK – ja.*
- c) Në rast se nuk merret me aktivitetet për të cilat është themeluar në kohëzgjatje për më shumë se 2 (dy) vite*
- d) Në rastet tjera të parashikuara me forcën e ligjit.*

**XV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

***Neni 59 .***

*Me miratimin e këtij Statuti, shfuqizohen dispozitat e tjera të mëparshme .*

*Të gjitha aktet normative të organizatave sportive , lidhjeve, klubeve dhe shoqatave, që janë anëtare të Federatës së Volejbollit të Kosovës, nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me këtë STATUT.*

*Të gjithë anëtarët e sipërmendur të FVK – së, duhet ti harmonizojnë Statutet dhe aketet tjera normative të tyre, me dispozitat e këtij Statuti, në afat prej 3(tre) muaj nga dita e aprovimit të këtij Statuti.*

*Plotësimet dhe ndryshimet e këtij Statuti bëhen në të njëjtën procedure si në rastin e aprovimit të tij*

***Neni 60 .***

*Statuti i FVK-së hynë në fuqi në ditën e aprovimit nga Kuvendi i FVK-së . Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, pushon të vlejë Statuti i aprovuar në muajin Shkurt të vitit 2002.*

***Neni 61 .***

*Interpretimin e këtij Statuti e bënë Kuvendi i Federatës së Volejbollit të Kosovës.*

***FEDERATA E VOLEJBOLLIT E KOSOVËS***

*K r y e t a r i*

*S e k r e t a r i*

---



---

***P R I S H T I N Ë***  
*Gusht, 2005*